



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISE
BORDI

VENDIM

Nr. 03, Datë 22.01.2024

MBI

“FILLIMIN E PROCEDURËS PËR MIRATIMIN E “PROCEDURAVE REZERVË PËR BASHKIMIN E TREGUT TË ENERGJISË ELEKTRIKE TË DITËS NË AVANCË SHQIPËRI - KOSOVË”

Në mbështetje të neneve 16 dhe 19 gërma “e” e ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike” i ndryshuar; pikës 3.5 të Vendimit të Këshillit të Ministrave (VKM) nr. 519, datë 13.07.2016 “Për miratimin e modelit të tregut të energjisë elektrike” i ndryshuar; nenit 3 pika 8 të “Rregullores së kërkesave dhe procedurave për përcaktimin e Operatorit të Emëruar të Energjisë Elektrike (NEMO) si dhe rolet e përgjegjësitë e NEMO dhe Operatorit të Sistemit të Transmetimit të Energjisë në tregun e bashkuar”, miratuar me vendimin e bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 40, datë 06.03.2020; “Rregullores së alokimit në hije të kapaciteteve (shadow auction) në kuadër të bashkimit të tregjeve Shqipëri-Kosovë”, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 308, datë 30.10.2023; neneve 15 dhe 19 të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.06.2016; si dhe “Marrëveshjes kornizë mbi bashkimin e tregjeve të energjisë elektrike të Shqipërisë dhe Kosovës” të datës 21.10.2021, nënshkruar nga Enti Rregullator i Energjisë i Shqipërisë (ERE), Zyra e Rregullatorit për Energji e Kosovës (ZRRE), Operatori i Sistemit të Transmetimit të Shqipërisë (OST) sh.a. dhe Operatori i Sistemit, Transmisionit dhe Tregut të Kosovës (KOSTT) sh.a., ndër të tjera; Bordi i ERE-s në mbledhjen e tij të datës 22.01.2024, pasi shqyrtoi relacionin me nr. 175 prot., datë 17.01.2024 të përgatitur nga Grupi i Punës “Mbi fillimin e procedurës për miratimin e metodologjisë së shpërndarjes së të ardhurave nga kongjestioni ndërmjet Shqipërisë dhe Kosovës dhe procedurave rezervë për bashkimin e tregut të energjisë elektrike të ditës në avancë Shqipëri - Kosovë”,

Konstatoi se:

- Shoqëria OST sh.a., me shkresën nr. 6250 prot., datë 06.12.2023, protokolluar me tonën me nr. 2070/1 prot., datë 07.12.2023, ka paraqitur në ERE për miratim “Procedurat Rezervë për Bashkimin e Tregut të Energjisë Elektrike të Ditës në Avancë Shqipëri – Kosovë”.
- Në zbatim të nenit 6.4, nën-paragrafi (h) të Marrëveshjes Kornizë, Rregullatorët do të miratojnë, ndër të tjera, *procedurat rezervë, të propozuar nga NEMO, OST dhe KOSTT.*
- Dokumenti i paraqitur për miratim është hartuar në përputhje me ligjin nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike” i ndryshuar, dhe në zbatim të nenit 7.3 nën-paragrafi (f) të

Marrëveshjes Kornizë së dakordësuar midis OST, KOSTT dhe NEMO-ve të Shqipërisë dhe Kosovës.

- Këto procedura rezervë janë një propozim i përbashkët i zhvilluar nga OST dhe KOSTT si Operatorë të Sistemit të Transmetimit, të cilët synojnë të sigurojnë alokim efikas, transparent dhe jodiskriminues të kapaciteteve, në rast se procesi i bashkimit të tregut të ditës në avancë Shqipëri - Kosovë nuk është në gjendje që të prodhojë rezultate.
- “*Procedurat Rezervë për Bashkimin e Tregut të Energjisë Elektrike të Ditës në Avancë Shqipëri – Kosovë*” janë miratuar ndërkohë nga Zyra e Rregullatorit për Energji e Republikës së Kosovës me vendimin e bordit të ZRRE V-1770 -2023, datë 21 shtator 2023.
- Në procedurat rezervë për bashkimin e tregut të energjisë elektrike të ditës në avancë Shqipëri - Kosovë parashikohet objekti dhe fushëveprimi, përkufizimet, baza ligjore mbi të cilën janë hartuar procedurat rezervë, informimi nga NEMO, kërkesa për një sistem të përbashkët komunikimi rezervë, procedura rezervë dhe pamundësia për fillimin e procedurave rezervë (Ankandit në hije).

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s,

Vendosi:

1. Fillimin e procedurës “Për miratimin e procedurave rezervë për bashkimin e tregut të energjisë elektrike të ditës në avancë Shqipëri – Kosovë”.
2. Drejtoria e Tarifave dhe Çmimeve, të njoftojë palët e interesit për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t’i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes dijeni, rishikimin e vendimit të bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI

Petrit AHMETI